



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**AUTORITETI I KONKURRENCES**  
**KOMISIONI I KONKURRENCES**

Njoftim për shtyp

**Mbi vendimin e Komisionit të Konkurrencës “Për shqyrtimin e kërkesës së ndërmarrjes “La Petrolifera Italo Albanese” për revokimin e vendimit Nr 140, datë 10.03.2010 të Komisionit të Konkurrencës”**

Komisioni i Konkurrencës, në mbledhjen e datës 18.03.2010 shqyrtoi çështjen me objekt shqyrtimin e kërkesës së ndërmarrjes “La Petrolifera Italo Albanese” SHA për revokimin e vendimit nr.140, datë 10.3.2010, të Komisionit të Konkurrencës, “Për marrjen e masave të përkohshme në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkim dhe depozitimit të gazit të lëngshëm”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të kërkesës së ndërmarrjes “La Petrolifera Italo Albanese” SHA, për revokimin e vendimit nr.140, datë 10.03.2010, të Komisionit të Konkurrencës, arriti në përfundimin se kërkesa e ndërmarrjes “La Petrolifera Italo Albanese” SHA, është e pabazuar në ligj dhe në prova. Gjithashtu kërkesa e paraqitur nga “La Petrolifera Italo Albanese” SHA për nxjerrjen e udhëzimeve për të mundësuar zbatimin e vendimit 140 të Komisionit të Konkurrencës është e pa mbështetur në Ligjin 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës vendosi rrëzimin e kërkesës së ndërmarrjes “La Petrolifera Italo Albanese”SHA dhe lënien në fuqi të vendimit nr.140, datë 10.3.2010, “Për marrjen e masave të përkohshme në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkim dhe depozitimit të gazit të lëngshëm”, si dhe rezimin e kërkesës së ndërmarrjes “La Petrolifera Italo Albanese” SHA për nxjerrjen e udhëzimeve në zbatim të vendimit nr.140, datë 10.03.2010 të Komisionit të Konkurrencës.

Vendimi i Komisionit të Konkurrencës ka hyrë në fuqi menjëherë dhe i është njoftuar palës.